



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 311 Prot.

Tiranë, më 20.11.2017
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: Përcillet Vendimi i Bordit të Akreditimit

DREJTUAR: KOLEGJIT UNIVERSITAR "BEDËR"
TIRANË

Bordi i Akreditimit, në mbledhjen e tij të rradhës, datë 10-11 Nëntor 2017, mori vendimin që lidhet me vlerësimin e jashtëm në kuadër të akreditimit institucional të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Bedër", pjesë e gjashtë Institucioneve të Grupit të gjashtë, në zbatim të kontratës së nënshkruar midis MAS dhe QAA dhe Manualit të posaçëm QAA – APAAL.

Lutemi, gjeni bashkëngjitur, Vendimin e Bordit të Akreditimit si më poshtë:

1. Vendim i BA Nr. 101, datë 10.11.2017 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Bedër"".

Gjithashtu, Ju informojmë se:

- Përmes Sistemit të Menaxhimit të ASCAL, ju janë vënë në dispozicion raporti përfundimtar origjinal i vlerësimit të jashtëm dhe rezultatet e pyetësorëve të stafit akademik dhe studentëve;
- Së shpejti do të njoftoheni për të tërhequr certifikatën e akreditimit;
- Vendimi i Bordit të Akreditimit dhe raporti përfundimtar origjinal janë publike në faqen zyrtare të internetit të ASCAL në adresën www.ascal.al.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

DREJTORI



Dhurata Bozo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË
BORDI I AKREDITIMIT

VENDIM

Nr. 101, datë 10.11.2017

PËR
AKREDITIMIN PERIODIK TË INSTITUCIONIT TË ARSIMIT TË LARTË
KOLEGJI UNIVERSITAR "BEDËR"

Bordi i Akreditimit, bazuar në Ligjin Nr. 80, datë 17.09.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 8480, datë 27.5.1999 "Për Funksionimin e Organeve Kolegjiale të Administratës Shtetërore dhe Enteve Publike", Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 109, datë 15.02.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë", Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 1, datë 07.04.2017, "Për mbylljen e procedurave të mbartura për shkak të riorganizimit të Institucioneve të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë" dhe Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 2, datë 07.04.2017, "Për përcaktimin e kohëzgjatjes dhe afateve të vlefshmërisë së akreditimit në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe Programeve të Studimit",

si dhe

në zbatim të Kontratës së Përgjithshme të Projektit "Për ofrimin e ekspertizës për Sigurimin e Cilësisë në mbështetje të krijimit të materialeve të vlerësimit të jashtëm të cilësisë, trajnimit të ekspertëve vlerësues të jashtëm dhe ekspertizës në mbështetje të vlerësimit të jashtëm të Institucioneve të Arsimit të Lartë në Shqipëri", Nr. 2064 Prot., datë 29.02.2016, lidhur ndërmjet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë së Garantimit të Cilësisë për Arsimin e Lartë në Mbretërinë e Bashkuar,

në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, në kuadër të vendimmarrjes për akreditimin institucional të **Institucionit të Arsimit të Lartë, Kolegji Universitar "Bedër"**, me të dhënat si më poshtë:

- a) Emërtimi i Institucionit të Arsimit të Lartë: **Kolegji Universitar "Bedër"**
- b) Organizimi i Institucionit: **Jopublik**
- c) Lloji i Institucionit: **Kolegj Universitar**
- d) Njësitë kryesore të Institucionit:
 - a. Fakulteti i Filologjisë dhe Edukimit

b. Fakulteti i Shkencave Humane

- e) Akti zyrtar i hapjes/licensimit: Vendim i Këshillit të Ministrave Nr. 286, datë 06.04.2011
- f) Urdhëri i Akreditimit të parë: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 223, datë 04.06.2013
- g) Akti zyrtar i riorganizimit: Urdhër i Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 616, datë 30.12.2016

pasi mori në shqyrtim:

- a. Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, përfshirë të dhënat e përgjithshme institucionale, Raportin e Vetëvlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës;
- b. Dokumentacionin e Vlerësimit të Jashtëm, përfshirë Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, dhe dokumentacionin shtesë;
- c. Vlerësimin e cilësisë në përmbajtje, të kryer nga ekspertët e Agjencisë Britanike dhe atyre vendas në përbërje të Grupit të Vlerësimit të Jashtëm;
- d. Rezultatet e Vlerësimit të Jashtëm të Institucionit në kuadër të akreditimit të parë;
- e. Mangësitë e evidentuara dhe rekomandimet e lëna nga vlerësimi i jashtëm;
- f. Procedurën e vlerësimit të ndjekur dhe monitoruar nga ASCAL;
- g. Komunikimin e vërejtjet e Institucionit në kuadër të këtij procesi;
- h. Raportin e ASCAL në lidhje me rezultatet e vlerësimit të jashtëm dhe akreditimit të parë për këtë Institucion si dhe plotësimin e rekomandimeve të lëna në kuadër të tyre;

konstaton se:

- a. Procedura dhe procesi i vlerësimit janë kryer në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore dhe afatet e përcaktuara në Kontratën MAS-QAA për këtë proces;
- b. Vlerësimi në përmbajtje është i mbështetur në Dokumentacionin e Vetëvlerësimit, Vlerësimin e Jashtëm dhe gjetjet e verifikimet gjatë vizitës në Institucion;
- c. Raporti është hartuar në përputhje me kërkesat dhe i mbështetur me fakte, të dhëna e dokumentacion plotësues;
- d. Rezultatet e vlerësimit janë nxjerrë në përputhje me gjetjet: pikat e forta dhe pikat e dobëta të identifikuar e verifikuara përmes dokumentacionit dhe vizitës në Institucion;
- e. Rekomandimet e lëna janë në koherencë me gjetjet si dhe shkallën e përmbushjes së standardeve të cilësisë për Institucionin në fjalë;
- f. Rezultatet e vlerësimit të Jashtëm në lidhje me shkallën e plotësimit të Standardeve Shtetërore të Cilësisë për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë sipas fushave janë: Fusha 1 “**përmbushen kryesisht**”, Fusha 2 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 3 “**përmbushen plotësisht**”, Fusha 4 “**përmbushen kryesisht**”, Fusha 5 “**përmbushen plotësisht**”, ndërsa vlerësimi i përgjithshëm “**përmbushen kryesisht**”;
- g. Vlerësimi përfundimtar i Grupit të Vlerësimit të Jashtëm për cilësinë akademike për këtë Institucion është Pozitiv me rekomandime;
- h. Rezultati i akreditimit të mëparshëm të këtij Institucioni është Pozitiv dhe janë plotësuar rekomandimet e lëna prej tij.



Mbështetur mbi rezultatet dhe arsyetimin e mësipërm, Bordi i Akreditimit,

VENDOSI:

1. **Vlerësimin Përfundimtar POZITIV** për Institucionin e Arsimit të Lartë **Kolegji Universitar "Bedër"**, me rekomandimet sipas Shtojcës së këtij Vendimi.
2. **Akreditimin Institucional** të Institucionit të Arsimit të Lartë, **Kolegji Universitar "Bedër"** me kohëzgjatjen prej **4 (katër)** vite akademike. Afati përfundimtar i vlefshmërisë së akreditimit të Institucionit është **09/11/2021**.
3. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij Vendimi, publikimin dhe lëshimin e certifikatës së akreditimit brenda 14 ditëve nga zbardhja e këtij vendimi, si dhe monitorimin e rekomandimeve sipas Shtojcës bashkëlidhur.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I AKREDITIMIT

ARJAN GJONÇA		Kryetar
ALEXANDER KOHLER		Anëtar
FABRICE HENARD		Anëtar
ARBEN MERKOCI		Anëtar
ALEKSANDËR XHUVANI		Anëtar
ANILA PAPARISTO		Anëtar
SULO HADERI		Anëtar
LULJETA MINXHOZI		Anëtar
MYFTAR BARBULLUSHI		Anëtar

ILIR PANDA



Anëtar

FATMIR GURI

Anëtar

Shënim: Z. F. Guri nuk ishte i pranishëm në këtë mbledhje.

Shtojca

Rekomandime

Kolegji Universitar "Bedër" duhet të ndjekë përmbushjen e rekomandimeve të mëposhtme të identifikuar nga ekspertët e grupit të vlerësimit, të renditura sipas prioritetit kohor të adresimit nga ana e tij, si vijon:

1. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Institucioni duhet të ndërmarrë hapa për vlerësimin e kërimit shkencor në zbatim të plotë të udhëzuesit përkatës për organizimin e konferencave shkencore dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për Kërkim, Projekte, Aplikime dhe Inovacione;
2. Institucioni duhet të përmirësojë në vijim zbatimin e politikave të integritetit për stafin dhe studentët e tij të huaj.

Kolegji Universitar "Bedër" duhet të hartojë një Plan Veprimi konkret për përmbushjen e këtyre rekomandimeve sipas afateve të mësipërme dhe ta dorëzojë atë pranë Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Ngarkohet ASCAL për ndjekjen e përmbushjes së këtyre rekomandimeve dhe raportimin në BA brenda afatit të përcaktuar në Planin e Veprimit.

